



Rama:
Subvencionimet
në bujqësi do të
bazohen tek
fatura

Faqe 2

**Hapen aplikimet për
Skemën Kombëtare
të Investimeve,
Denaj: 2 miliardë
lekë mbështetje për
bujqësinë**

Afati i aplikimit:
30 korrik - 30 shtator 2025

Faqe 2

**Shëndeti dhe Siguria
në Bujqësi - KASH
organizon seminar
në Fier në kuadër
të projektit SAGRI**

Faqe 2



AGROBIZNESI

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR

Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al



Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh,
Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

15-ditëshi i parë i muajit gusht 2025

Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 515
Çmimi 125 lekë

E përdyjavshme e pavarur

VLERËSIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS PËR BIMËT AROMATIKE DHE MJEKËSORE (BAM) NË SHQIPËRI RRITJA E KONKURRUESHMËRISË PËRMES STANDARDEVE DHE CERTIFIKIMEVE: NJË RRUGË DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM PËR FERMERËT DHE NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (NVM)

Qeveria Zvicerane mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde (GQSP) që zbatohet nga UNIDO, duke synuar të rrisë në mënyrë të qëndrueshme aksesin në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare për NMV-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&P duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet



**AZHBR publikon listën
me 837 aplikantët
e kualifikuar për
mbështetje në serra**

Faqe 4

INOVACION

**Stacioni i startup-eve,
tre të rinj ndërtojnë
platforma teknologjike
për bujqësinë**

Faqe 10

LEGJISLACION

**Projektligji "Për Censin e Bujqësisë", qeveria hedh hapa
për regjistrimin e fermave dhe njësive ekonomike
bujqësore në nivel rajonal dhe kombëtar**

Faqe 10

TEMA TË DITËS

- **Fatos Çoçoli: Çfarë fitojmë nga fatura e qumështit?** Fq.7
- **Interes për Paketën e Maleve, paraqiten kërkesat e para për investime në Tepelenë** Fq.10
- **Grup pune për zgjidhjen e çështjes së vaditjes në Myzeqe** Fq.10
- **Hyn në fuqi vendimi i qeverisë për tarifat e reja për përdorimin e kullotave dhe livadheve** Fq.11
- **Drurët dhe pemët më të pazakonta në Tokë - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari** Fq.13

MEKANIZIM

**Makineritë bujqësore
pa TVSH, hapat për të
përfituar agrobiznesi**



Faqe 5

TEMA TË DITËS

Rama: Subvencionimet në bujqësi do të bazohen tek fatura

Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me kryetarët

subvencionimi i përgjithshëm po e quaj, tek subvencionimi



e bashkive, për performancën lokale në funksion të vizionit “Shqipëria 2030” dhe rrugës së pandalshme drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Duke folur për vizionin “Bujqësia 2030”, Rama foli për efikasitetin e drejtorive.

“Ne jemi vend shumë i vogël për të pasur drejtori gjithandej edhe kaq sa janë, janë shumë. Sepse kur vjen puna tek efikasiteti pastaj, e keni parë vetë sesa efikase janë. Dhe problemi nuk është se është në Korçë apo Pogradec, problemi është sa efikase është drejtorja dhe aty pastaj tek efikasiteti mendoj se ka shumë për të korrigjuar”, tha Rama.

Rama u shpreh se “në takimin me fermerët në Cërrik u tha qartë që do të lëvizim nga

mbështetjen përkatëse. Kush do të vazhdojë të operojë pa faturë në mënyrë informale nuk ka pse të pretendojë të subvencionohet për një arsye shumë të thjeshtë, se pastaj në këtë formë primitive subvencionimi përfitojnë shumë nga ata që nuk janë as prodhues dhe nuk janë as kontribuues”, tha Rama.

Ashtusikundër, shtoi kryeministri, “tokat e dhëna me qira, ose në përdorim të të tretëve që i punojnë, marrin subvencion, po atë subvencion nuk e marrin ata që punojnë tokën dhe që i nxjerrin prodhimin, por e marrin ata që e kanë dhënë me qira dhe që mund të jenë dhe në



për njësi prodhuese”.

“Pra nuk do të subvencionojmë përpara, do të subvencionojmë bazuar tek fatura. Kush tregon faturën e gjësë që ka prodhuar dhe shitur do të marrë

Itali apo në Greqi. Ky është një tjetër boshllëk që do të duhet ta adresojmë dhe pikërisht adresimin do ta bëjmë duke u spostuar drejt atyre që janë në gjendje të tregojnë faturën”.

Rama: Të ndryshojë seriozisht menaxhimi i mbetjeve të fshatit


Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me kryetarët e bashkive, për performancën lokale në funksion të vizionit “Shqipëria 2030” dhe rrugës së pandalshme drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

Duke folur për vizionin “Bujqësia 2030”, Rama vuri theksin edhe tek domosdoshmëria për t’u marrë seriozisht me mbetjet e fshatit edhe për të ndryshuar seriozisht menaxhimin edhe të mbetjeve të fshatit duke marrë shembullin e Cërrikut.

“Kemi edhe shembullin e Roskovecit, që nuk është tamam si ai i Cërrikut, se nuk është plotësisht i suksesshëm, por që prapë është një shembull që duhet marrë, në mënyrë që të ndryshojë situata me mbetjet. Se do jetë një problem shumë i madh. Shumë shumë i madh. E dëgjua në paraqitjen që bëri Majlinda. Do të jetë një problem që do vazhdojë edhe pas anëtarësimit”, theksoi Rama.

Kështu që, shtoi kryeministri, “na duhet patjetër që paralelisht me krijimin e operatorit të trajtimit të mbetjeve në

nivel kombëtar për sa i përket gjithë atyre 200 depozitimeve, landfillëve, inceneratorëve, për të pasur një gjë të koordinuar, të qendëruar, të filloni të punoni nëpër bashki për ndarjen në burim, për riciklimin, për ripërdorimin. Se nuk mund të jetë kjo histori hidh plehrat, mbulo kazanët me plehra dhe pastaj merr gjysmën e plehrave çoi në



vend-depozitim edhe gjysmën tjetër lëri që të presin gjysmën që vjen të nesërmen që mbulon prapë kazanët e plehrave”.

Kjo, tha Rama, “është një pjesë jashtëzakonisht sfiduese e kalimit nga fshati në qytet. Në

kuptimin e të bërit nga një vend fshat në një vend qytet i Europës dhe i kalimit nga një shekull në një shekull tjetër në aspektin e përkatësisë europiane”.

“Nuk mund të jemi një vend i BE-së me plehrat që gjysma mbledhen edhe hidhen të pandara dhe pa asnjë riciklim diku dhe gjysma tjetër lihen të kalben nëpër rrugë”, nënvizoi

Rama.

Ndërkohë, kreu i qeverisë evidentoi Beratin, i cili tha ai, “ka ndërtuar një pikë shumë mbresëlënëse riciklimi. Edhe ajo duhet parë se nuk është ndonjë shkencë shumë e madhe”.

Shëndeti dhe Siguria në Bujqësi - KASH organizon seminar në Fier në kuadër të projektit SAGRI

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH), në kuadër të projektit ndërkufitar SAGRI, organizoi në ambientet e shkollës “Rakip Kryeziu” në Fier një seminar tematik mbi Shëndetin dhe Sigurinë në Bujqësi.

Ky aktivitet u zhvillua si pjesë e programit Interreg IPA Itali-Shqipëri-Mali i Zi, me pjesëmarrjen e fermerëve, agrobiznesmenëve dhe aktorëve të sektorit bujqësor nga Fierit dhe zona përreth. Seminari synoi të rrisë ndërgjegjësimin dhe kapacitetin e fermerëve në drejtim të zbatimit të praktikave të sigurta dhe të qëndrueshme në bujqësi, përmes teknologjive agro-mjedisore moderne.



Gjatë seminarit, ekspertët e KASH dhe të bujqësisë diskutuan mbi disa çështje kyçe, si:

- Udhëzuesi dhe Plani i Veprimit për sigurinë në fermat shqiptare
- Modelet strategjike të menaxhimit për parandalimin e rreziqeve në bujqësi
- Rreziqet kimike, biologjike dhe ergonomike, si dhe mënyrat praktike për t’i identifikuar dhe menaxhuar

Fermerët u angazhuan aktivisht në diskutime dhe ndanë përvoja konkrete nga praktikatat e përditshme, duke shfaqur interes të lartë për aplikimin e njohurive të reja në fermat e tyre.

Projekti SAGRI synon t’u ofrojë punonjësve të sektorit bujqësor njohuri dhe aftësi për të kuptuar dhe menaxhuar sistemet agro-mjedisore, duke i trajtuar ato si ekosisteme të modifikuara nga aktiviteti njerëzor. Përdorimi i teknologjive të avancuara mjedisore është në qendër të projektit, me qëllim rritjen e qëndrueshmërisë dhe produktivitetit në bujqësi.

KASH vijon të luajë një rol aktiv në forcimin e kapaciteteve të fermerëve shqiptarë, duke i përgatitur ata për sfidat e kohës dhe për përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian në sektorin bujqësor.



Hapen aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve, Denaj: 2 miliardë lekë mbështetje për bujqësinë

Aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve 2025 për sektorin bujqësor hapen duke ofruar një paketë financimi të integruar që përfshin kredinë e butë dhe mbështetje financiare përmes granteve, njoftoi në rrjetet e saj sociale Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj.

Sipas Denaj, kjo skemë ka për qëllim rritjen e konkurrueshmërisë dhe fuqizimin e inovacionit në zinxhirin agroushqimor, duke siguruar gjithashtu përmbushjen e standardeve të BE-së për sigurinë ushqimore.

“Për më tepër, ajo synon realizimin e objektivit ambicioz të qeverisë për eksportimin e 1 miliard eurove produkte bujqësore deri në 2030-ën.

Për të mbështetur zhvillimin bujqësor, Skema Kombëtare e

Investimeve 2025 ofron një fond rekord prej 20 milionë eurosh, të cilat janë të strukturuar në nëntë masa mbështetëse, të cilat mund të përdoren nga fermerët dhe

vetëm 2% dhe 70% kolateral nga shteti, gërshetohet me Skemën Kombëtare të Investimeve 2025 me 50% grant, duke krijuar një paketë të plotë finan-



subjektet bujqësore për të zhvilluar plane investimi të personalizuar”, thekson Ministria Denaj.

Kredia e butë e nisur prej janarit, me një normë interesi

cimi për sektorin bujqësor.

Ministria sqaron në postimin e saj, se aplikantët mund

(Vijon në faqen 6)

VLERËSIMI I ZINXHIRIT TË VLERËS PËR BIMËT AROMATIKE DHE MJEKËSORE (BAM) NË SHQIPËRI

RRITJA E KONKURRUESHMËRISË PËRMES STANDARDEVE DHE CERTIFIKIMEVE: NJË RRUGË DREJT ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM PËR FERMERËT DHE NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME (NVM)

Qeveria Zvicerane mbështet sektorin bujqësor nëpërmjet ndërhyrjeve të Programit Global Për Cilësi dhe Standarde (GQSP) që zbatohet nga UNIDO, duke synuar të rrisë në mënyrë të qëndrueshme aksesin në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare për NMV-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&P duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet

Ky artikull është pjesë e një raporti që detajon rezultatet e vlerësimit të zinxhirit të vlerës për bimët mjekësore dhe aromatike (BAM). Ky vlerësim u krye në kuadër të projektit “Analiza e zinxhirit të vlerës së bimëve aromatike mjekësore dhe frutave dhe perimeve në Shqipëri”, e mandatuar nga UNIDO, si pjesë e Programit Global të Cilësisë dhe Standardeve (GQSP) dhe financuar nga Qeveria Zvicerane nëpërmjet Sekretariatit të saj Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO). Një raport përkatës është përgatitur edhe për sektorin e frutave dhe perimeve (F&P).

GQSP në Shqipëri synon të rrisë në mënyrë të qëndrueshme aksesin në treg për NVM-të në zinxhirët e vlerave BAM dhe F&P duke forcuar cilësinë dhe kapacitetin e përputhshmërisë me standardet. Programi fokusohet në infrastrukturën e cilësisë dhe pajtueshmërisë, si dhe në kërkesat ekonomike, sociale dhe të qëndrueshmërisë.

DISPOZITAT E BE-SË PËR PRODHIMET ORGANIKE DHE STANDARDET MË TË KËRKUARA NË TREGJET GLOBALE

Dispozitat e BE-së për prodhimin organik

Kërkesa për prodhime organike përfaqëson një pjesë të konsiderueshme dhe në rritje të kërkesës totale për produkte agroushqimore në vendet e EEA. Pjesa e tregut varion nga rreth 1% në 6% në shumicën e vendeve të Evropës lindore dhe jugore, deri në 11% në 27% në Danimarkë, Zvicër, Suedi dhe Austri.

Prodhimi organik në shumicën e vendeve është i rregulluar me ligj, dmth një produkt duhet të jetë në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore për t’u konsideruar organik, si pasojë zgjedhja për të prodhuar nën regjimin organik është vullnetare, por prodhimi i nënshtrohet kërkesave ligjore. Një produkt që nuk përputhet me kërkesat ligjore të prodhimit organik mund të eksportohet ende në vendet e ZEE-së, me kusht që të përputhet me kërkesat për prodhime jo organike, siç detajohet më sipër.

Baza ligjore për prodhimin organik në BE është Reg. (BE) 2018/848, i cili hyri në fuqi në janar 2022. Disa rregullore të tjera të deleguara dhe zbatuese po rregullojnë tregtinë e produkteve organike.

Prodhuesit e vendeve të treta duhet të respektojnë të njëjtat rregulla si ata që prodhojnë në Bashkimin Evropian, për t’u lejuar të eksportojnë produkte organike në vendet e BE-së. Dispozitat kryesore përfshijnë:

- Përpara se të certifikojnë një produkt si organik, prodhuesit duhet të kenë përdorur këto metoda prodhimi për të paktën 2 vjet gjatë gjithë periudhës së konvertimit;
- Prodhuesit duhet të ruajnë pjellorinë e tokës dhe mbajtjen e ujit, të shmangin kontaminimin e kryqëzuar dhe, të përdorin inputet organike dhe materiale organike të shumimit (dmth fara dhe fidane);
- Për t’u certifikuar si fermer ose eksportues organik, është e nevojshme të regjistroheni dhe të certifikoheni nëpërmjet një *organi kontrolli të njohur ose certifikues të akredituar*, për verifikimin e respektimit të rregullave organike. Kryhen inspektime dhe kontrole vjetore për verifikimin e pajtueshmërisë së vazhdueshme me kërkesat ligjore të regjimit të prodhimit organik;

Pasi të jetë audituar nga një certifikues i akredituar, prodhuesi ose eksportuesi mund të përdorë logon organike të BE-së (shih Figurën 1 më poshtë) në produktet e tij, së bashku me logon e mbajtësit të standardit.

Çështja e certifikuesve të akredituar ka qenë prej shumë vitesh një pengesë për rritjen e prodhimit organik shqiptar për eksport. Zgjidhja e miratuar konsistonte në krijimin e degëve të organeve të njohura të kontrollit të krijuara në vendet e BE-së, të cilat kryenin procesin e auditimit, kontrolleve dhe certifikimit.

Figura1: Etiketa zyrtare organike për produktet organike në Evropë



Të gjitha produktet organike të importuara në BE duhet të kenë certifikatën e duhur elektronike të inspektimit (e-COI). Këto certifikata menaxhohen përmes TRACES. Pa një certifikatë elektronike të inspektimit, produktet nuk do të lëshohen nga porti i tyre i mbërritjes në Bashkimin Evropian.

Standardet dhe certifikatat më të kërkuara në tregjet e EEA BAM

Kategoritë e standardeve dhe certifikimeve

Kriteret kryesore standarde të kategorizimit të lidhura me këtë studim lidhen me: i) qëllimin dhe, ii) zhvilluesin/pronën. Tabela e mëposhtme tregon një strukturë të thjeshtuar të standardeve kryesore përkatëse aktualisht në përdorim, sipas këtyre dy kategorive.

Tabela 1. Tabela sinoptike e standardeve kryesore përkatëse ISO dhe private sipas fushëveprimit dhe zhvilluesit		
Zhvilluesi/prona	ISO	Lëndët private
Fushëveprimi		
Menaxhimi	Familja ISO 9000 (r. 5), sistemi i menaxhimit të cilësisë	
Siguria e ushqimit	Familja ISO 22000 (rr. 4)	Ato kryesore: FSSC 22000
Zinxhiri i përgjithshëm i furnizimit		Ato kryesore: • GlobalG.AP. familja dhe shtesat (prodhimi dhe pas vjeljes); • LCG-BRCGS (ushqim i përpunuar); • GFSI-IFS (përpunimi i ushqimit);
Segmentet e zinxhirit të furnizimit		
	• ISO 27001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit); • ISO 28001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë);	
Kompanitë dhe funksionet e zinxhirit të vlerës	• ISO 37001 (sistemi i menaxhimit kundër ryshfetit); • ISO 10002 (kënaqësia e klientit); • ISO 22301 (vazhdimësia e biznesit, elasticiteti);	
Qëndrueshmëria	• ISO 45001 (Shëndeti dhe Siguria në Punë); • ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit); • ISO 50001 (Menaxhimi i Energjisë);	Mbi 300 VSS; kryesoret: NVMTA, Fairtrade, Rainforest, SA 8000, disa GlobalG.AP. shtesa, panair forLife, BSCI
Vlerat kulturore		• Hallall (të ndryshëm sipas vendit dhe TIC); • Kosher (ndryshe nga TIC).

Miratimi i një standardi nga një kompani ndjek një proces kompleks, i cili përfshin aktivitete auditimi, inspektimi dhe certifikimi nga një subjekt i pavarur dhe i specializuar i akredituar, i njohur kolektivisht si organe TIC (Testing, Inspection, Certification). TIC lëshon gjithashtu certifikatat e përputhshmërisë me kërkesat ligjore, të tilla si aplikimi HACCP, për të cilin zbatimi është i detyrueshëm në shumicën e vendeve, por jo certifikimi i pajtueshmërisë.

Në disa raste, standardet private zhvillohen nga grupe interesi, të tilla si GFSI (Aleanca Globale e Sigurisë Ushqimore), ndonjëherë duke pasur statusin e OJQ-së (si Rainforest).

Në raste të tjera, blerës të mëdhenj, si zinxhirët e supermarketeve ose grupet ose shoqatat e shitësve me pakicë, i kanë formalizuar kërkesat e tyre në standarde të pronarit, zakonisht të zhvilluara së bashku me TIC

Në shumë raste, vetë TIC-të kanë zhvilluar gjithashtu standarde të pronarit.

Një tendencë relativisht e fundit lidhet me përhapjen e standardeve pronësore të qëndrueshmërisë, pra standardeve që synojnë përmbushjen e treguesve që lidhen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së, si siguria e punëtorëve, trajtimi i drejtë i punëtorëve dhe furnitorëve, përdorimi i qëndrueshëm i vlerave mjedisore, çështjet gjinore. Këto standarde të pronarit njihen kolektivisht si Standarde Vullnetare të Qëndrueshmërisë. Sipas përkufizimit të UNCTAD “*Standardet Vullnetare të Qëndrueshmërisë (VSS) janë standarde private që kërkojnë që produktet të plotësojnë metrika specifike të qëndrueshmërisë ekonomike, sociale dhe mjedisore. Kërkesat mund t’i referohen cilësisë ose attributeve të produktit, por edhe metodave të prodhimit dhe përpunimit, si dhe transportit*”.

VVS zakonisht përfshin disa tregues të qëndrueshmërisë që lidhen me OZHQ të ndryshme (p.sh. Tregtia e drejtë). Zhvillimi i tyre ka ndjekur me kohë krijimin e standardeve të qëndrueshmërisë ISO, të fokusuara zakonisht në menaxhimin e një aspekti të vetëm të qëndrueshmërisë (p.sh. ISO 450001 për shëndetin dhe sigurinë në punë ose ISO 50001 për menaxhimin e energjisë.

Riorganizohen institucionet inspektuese të qeverisjes qendrore

Këshilli i Ministrave miratoi vendimin për procesin e organizimit të institucioneve me funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore, në fushën e zbatimit të ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Në vendimin e qeverisë thuhet se institucionet që i nënshtrohen procesit të riorganizimit janë Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Agjencia Kombëtare e Mjedisit; Agjencia Kombëtare e Pyjeve; Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura; Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve; Autoriteti Kombëtar i Ushqimit; Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave; Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit; Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore; Inspektorati Shtetëror Shëndetësor; Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Inspektorati

Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Instituti i Shëndetit Publik.

Funksionet inspektuese të Agjencisë Kombëtare të



Arsimit Parauniversitar dhe të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit transferohen në inspektoratet e reja qendrore, që do të krijohen sipas fushave të inspektimit, që mbulojnë ministrinë përgjegjëse dhe sipas parimeve të ligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Për ndjekjen dhe zbatimin e vendimit ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,

Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Brendshme, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

AZHBR publikon listën me 837 aplikantët e kualifikuar për mbështetje në serra

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) publikoi listën e fermerëve përfitues nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025, për masën “Mbështetje për serra dhe kontroll biologjik”.

Sipas Agjencisë për Zh-

nga Skema Kombëtare e Mbështetjes në Bujqësi 2025, për mbështetje në prodhimin e perimeve në serra.

AZHBR bën të ditur se, pagesa për këtë masë parashikon financim të fermerëve, në vlerën deri në 200 000 lekë për ha për kultivimin e peri-

jo më pak se një ha.

Për sipërfaqen mbi 5 ha masa e përfitimit zvogëlohet me 50%, përjashtuar rastet e aplikantëve me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”.

Gjithashtu përfitojnë pagesë shtesë fermerët që përdorin kontrollin biologjik të dëmtuesve të perimeve (domate, specia, tranguj, luleshtrydhe).

Masa e përfitimit është në 50% të vlerës totale të faturave tatimore për blerjen e materialeve biologjike, përfshirë insektet e dobishme, por jo më shumë se 30 000 mijë lekë për dynym, në rastin e dy mbjelljeve në vit.

Për fermerët individualë, që aplikojnë për mbështetje vetëm për kontrollin biologjik, sipërfaqja minimale e kultivuar është 3 dynym, ndërsa për aplikantët me status “Grup fermerësh” ose “SHBB”, sipërfaqja minimale është një ha për secilën nga mbjelljet.



villim Bujqësor dhe Rural, (AZHBR) janë 837 aplikantë të shpallur përfitues të financimit të drejtëpërdrejtë

meve, rrushit për tavolinë në serra dhe/ose luleshtrydhe në tunele plastike për fermer/aplikant, me sipërfaqe të mbjellë

UNIDO

Rritja e konkurrueshmërisë përmes standardeve dhe certifikimeve: një rrugë drejt zhvillimit të qëndrueshëm për fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM)

(Vijon nga faqja 3)

Kërkesa për prezantimin e standardeve dhe shërbime TIC

Rezultatet e anketës në terren

Rezultatet e sondazhit në terren dëshmuar se edhe nëse blerësit ndërkombëtarë të BAM-ve dhe vajrave esenciale BAM shqiptarë kërkojnë shpesh parametra shtesë ose të rreptë (p.sh. MRL) në krahasim me kërkesat ligjore, ka një kërkesë relativisht të vogël për zbatimin e certifikuar të standardeve të pronarit.

Megjithatë, ka kërkesa të mira për produkte organike, kështu që 28% e sipërmarrësve të kampionuar janë prodhues organikë të certifikuar (EU-Bio, BioSuisse, USDA Organic).

Gjithashtu, disa operatorë, veçanërisht në sektorin e BAM-ve janë certifikuar ISO 9001:2015 (14% e kampionit), si një mjet për të ndërtuar besueshmërinë si partnerë të besueshëm. Certifikimi i sistemit të cilësisë është më pak i zakonshëm: 6% e mostrës është e certifikuar FSSC22000, një standard privat i bazuar në ISO 22000, me veçori shtesë.

Standardi më i zakonshëm i sigurisë ushqimore për produktet e përpunuara është BRCGS (10% e mostrës totale), por miratohet vetëm nga përpunuesit/eksportuesit e BAM.

Së fundi, ka një kërkesë të konsiderueshme për shërbime TIC për certifikimin HACCP, pasi 20% e kompanive të mostrës e kanë këtë certifikim¹.

Tabela 2 më poshtë përmbledh frekuencën e ndërmarrjeve të certifikuara brenda objektit kampion të vrojtimit në terren. Është e rëndësishme të nënvizohet se një kompani e vetme mund të mbajë më shumë se një certifikim.

Tabela 2. Pjesa e ndërmarrjeve të mostrës që mbajnë certifikata të ndryshme	
Certifikimin	Pjesa e mostrës
Organike (Bio) USDA Organike ose BioSUISSE Organike	28%
HACCP	20%
ISO 9001:2015	14%
BRCGS	10%
Kosher	10%
FSSC 22000	6%
Aleanca e pyjeve të shiut	2%
Tregti të ndershme	2%
Auditimi Etik i Tregtisë së Anëtarëve të Sedex (NVMTA)	2%
Të tjerët	6%

Burimi: Anketa UNIDO/GQSP 2023

Standardet dhe certifikatat në lidhje me menaxhimin e cilësisë dhe sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore

Standardet më të njohura dhe të miratuara për menaxhimin e cilësisë dhe sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore janë përkatësisht ISO 9001:2015 dhe ISO 22000:2018; megjithatë, duke qenë se ISO 22000:2018 nuk njihet nga GFSI, shumë sipërmarrje dhe blerës preferojnë standardin privat FSSC 22000, i cili njihet dhe ngulit ISO 22000:18 nga GFSI, plus disa standarde teknike (TS) të familjes ISO 22000 dhe të tjera karakteristika specifike të FSSC 22000.

Në mesin e ndërmarrjeve të mostrës, certifikimi HACCP është mjaft i zakonshëm (20% e totalit). HACCP nuk është një standard, por një sistem i menaxhimit të sigurisë ushqimore, aplikimi i të cilit është i detyrueshëm në shumicën e kuadrit ligjor të ushqimit (përfshirë ato në

për pajtueshmërinë nuk është i detyrueshëm. Parimet dhe hapat HACCP janë të ngulitura në ISO 22000:2018, së bashku me disa veçori dhe komponentë të tjerë.

Asnjë ndërmarrje nga ato të përfshira në mostër nuk është e certifikuar me ISO 22000:2018. Megjithatë, 6% e ndërmarrjeve të mostrës janë të certifikuara FSSC 22000, i cili është një standard privat që përfshin ISO 22000:2018 siç përshkruhet më poshtë. Avantazhi i FSSC 22000 ndaj ISO 22000:2018 është se FSSC 22000 njihet nga GFSI, ndërsa ISO 22000:2018 jo.

Një tjetër standard privat relativisht i popullarizuar për sigurinë dhe cilësinë e ushqimit është BRCGS: 10% e ndërmarrjeve të mostrës janë të certifikuara BRCGS.

Kategoritë VSS dhe kërkesat e përgjithshme të blerësve të BE-së për VSS

Standardet Vullnetare të Qëndrueshmërisë – VSS janë standarde të lidhura me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm; këto VSS zakonisht ndahen në nëntë nënkategoritë, përkatësisht: i) Kujdesi i duhur, ii) Besueshmëria, iii) Gjurmueshmëria, iv) Siguria e Ushqimit, v) Cilësia, vi) Biznesi qëndrueshëm, vii) Të drejtat e njeriut dhe të punës viii) Mjedisit dhe ndryshimet klimatike dhe, ix) Gjinia. Çdo VSS mund të përfshihet në një ose më shumë kategori, në varësi të fushëveprimit të tij.

Disa standarde ISO si ISO 45001 (Shëndeti dhe Siguria në Punë), ISO 14001 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor) dhe ISO 50001 (Menaxhimi i Energjisë) janë gjithashtu të lidhura me OZHQ, por nuk mund të klasifikohen si VSS sipas përkufizimit të UNCTAD.

Ekziston një numër i madh i VSS. Baza e të dhënave ITC StandardsBAM (Harta Standarde, 2022), merr në konsideratë mbi 300 VSS , shumë prej të cilave janë pjesë e familjeve VSS, si GlobalG.AP., e cila përbëhet nga standarde thelbësore, module specifike të orientuara nga prodhimi (të cilat gjenerojnë një standard të veçantë) dhe module shtesë. Disa blerës të mëdhenj, si zinxhirët e supermarketeve, zhvillojnë së bashku me kompanitë audituese standardet e tyre (p.sh. Tesco me GlobalG.AP., me modulin shtesë Nurture 11.4)

Është e mundur që të kërkohen certifikata të shumta, secila e lidhur me një fazë specifike të zinxhirit të furnizimit, ose një kombinim i llojeve të ndryshme të certifikimeve. Për shembull, është e mundur që BRCGS të kërkohet për sigurinë ushqimore (BRCGS FoodSafety v9) dhe, përveç kësaj, certifikimin NVMTA ose Fairtrade për kushtet e punëtorëve (NVMTA) ose menaxhimin e kontratave të prodhimit (Fairtrade). Gjithashtu, mund të kërkohet certifikimi për përputhshmërinë me kërkesat dhe standardet e kategorive të ndryshme (p.sh. certifikim organik, plus ISO 9001:2018, plus BRCGS FoodSafety v9)

Në përgjithësi, aplikimi i standardeve vullnetare kërkohet gjithnjë e më shumë nga blerësit. Në shumë raste, kërkohen kërkesa specifike, të cilat nuk lidhen me një standard të formalizuar.

Standardet që lidhen me vlerat kulturore dhe fetare

Standardet më të zakonshme të kësaj kategorie janë ato produkte të klasifikuara si “Hallall” dhe “Kosher”. Në Shqipëri ka një zinxhir të plotë furnizimi të specializuar për produktet “Hallall”, por jo eksportues BAM.

Përkundrazi, në tregun vendas shqiptar është mjaft e rrallë të gjesh produkte të certifikuara “Kosher”, ndërkohë që 10% e sipërmarrjeve të shqyrtuara në studim janë të certifikuara “Kosher”.

¹ HACCP është një sistem menaxhimi i përfshirë në shumicën e legjisllacionit për ushqimin në Workld , zbatim i të cilit është i detyrueshëm në legjisllacionin e BE-së, SHBA-së dhe Shqipërisë; megjithatë, certifikimi për pajtueshmërinë nuk është i detyrueshëm.

BUJQËSI

Subvencionet nxisin interesin, 450 blegtorë nga qarku Shkodër aplikojnë në skemat mbështetëse

Përfshirja këtë vit e një mase të re në skemat mbështetëse të qeverisë për blegtorët që rrisin viça për majmëri, ka

masë pritët të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e cilësisë së mishit vendas dhe në uljen e importit nga jashtë.



shtuar numrin e aplikuesve nga qarku i Shkodrës. Sipas specialistëve të fushës, kjo

“Kjo bëhet për të nxitur interesin e fermerëve që ti mbarështojnë kafshët duke pa-

sur parasysh që produktet janë shumë më cilësore se ato që importohen”, u shpreh Mark Reçi, specialist i Shërbimit Veterinar Shkodër.

Një nga kriteret kryesore për të përfituar nga skemat mbështetëse është numri i krerëve që zotëron ferma, çka ka nxitur edhe më shumë fermerët të rrisin kapacitetin e tyre prodhues, shpeshherë edhe përmes grupeve.

“Shumë ferma sidomos në zonën e Bushatit, sot ka ferma të cilat kanë mbi 200 krerë lopë”, tha ai.

Për vitin 2025, nga qarku i Shkodrës kanë aplikuar rreth 450 blegtorë, ndërsa më shumë se gjysma e tyre kanë synuar përfitimin nga skema shtese për gjedhin e matrikulluar.

Mbështetje fermerëve të Kukësit dhe Dibrës për kultivimin e mjedrës

Kultivimi i frutit të mjedrës, një kulturë e re në vendin tonë, falë mbështetjes nga ekspertët e bujqësisë, po realizohet me sukses nga fermerët në vendin tonë.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, njoftoi realizimin me sukses të mbjelljes së fidanëve të mjedrës nga fermerët në Dibër dhe Kukës.

Ajo e cilësoi këtë iniciativë, një hap konkret drejt kultivimit të kësaj kulture të re, që është fitimprurëse dhe ka kërkesë të lartë në treg për të.

“Falë mbështetjes së GIZ dhe njohurive të fituara nga trajnimet praktike dhe përgatitjet në terren, fermerët po zbatojnë teknika moderne që rrisin efikasitetin në përdorimin e tokës dhe cilësinë e prodhimit, duke e bërë sektorin bujqësor më të qëndrueshëm për të ardhmen”,

u shpreh Denaj.

Mjedra bën pjesë në grupin e pemëve manore me vlera të larta ushqyese dhe ekonomike.

në Kosovë dhe falë mbështetjes nga Skemat Kombëtare, fermerët kanë nisur të investojnë për kultivimin e saj, që kërkon teknologji



Ajo është e pasur me vitamina, minerale dhe antioksidantë.

Mjedra kultivohet gjerësisht

të posaçme, teksa kushtet klimatike në Shqipëri e favorizojnë zhvillimin e mjedrës.

Regjistrimet në arsimin profesional, Denaj: Drejtimi bujqësor, punësim i sigurt

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj njoftoi se ka nisur tashmë procesin për regjistrimet në arsimin profesional, ndërsa i ftoi të rinjtë që përfundojnë klasën e 9-të që të zgjedhin drejtimin bujqësor, për punësim të sigurt.

“Nxënësit mund të regjistrohen në një nga shkollat profesionale bujqësore që janë në 5 qarqe të vendit: Shkolla profesionale “Rakip Kryeziu”, Fier; Shkolla profesionale “Mihal Shahini”, Cërrik; Shkolla e mesme profesionale Kamëz; Shkolla Profesionale Shërbime, Korçë; Shkolla profesionale “Ndre Mjeda”,

Bushat dhe shkolla profesionale “Charles Telford Erickson”,



Golem”, tha Denaj.

Ministria i ftoi të rinjtë të investojnë në dije për t’u bërë pjesë e zhvillimit të bujqësisë së qëndrueshme në Shqipëri, teksa njoftoi se, regjistrimi bëhet lehtësisht përmes portalit e-Albania, në shërbimin “Regjistrohu në klasën e dhjetë”.

Të rinjtë që mbarojnë klasën e 9-të kanë tani një mundësi për të ndërtuar një karrierë të qëndrueshme dhe të suksesshme në sektorin bujqësor, përmes arsimit profesional në një nga tre drejtimet më të kërkuara në treg: bujqësi, veterinari dhe teknologji ushqimore.

Skema e investimeve, lidhen 251 kontrata - Në 4 muaj janë disbursuar fondet për 7 përfitues

Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural ka lidhur 251 kontrata me bizneset në fushën e bujqësisë gjatë 4 muajit të parë të këtij viti nga të cilat janë disbursuar fondet vetëm për 7 përfitues me vlerë 5.5 milionë lekë.



Sipas dokumentit për zbatimin e buxhetit 2025, pjesa tjetër e disbursimit pritet të përfundojë deri në muajin Gusht.

Skema e investimeve 2024 mbështet fermerët në disa masa, siç është mekanizimi i bujqësisë, ndërtimi i stallave dhe stabilimenteve; sera diellore; rrjetat antiibreshër si dhe akuakulturën

dhe fondi është 5 milionë euro.

Procesi i aplikimeve për Skemën Kombëtare të Investimeve në Bujqësi 2024 ka përfunduar më 8 nëntor 2024, ndërsa afati i afati i fundit për dorëzimin e dokumenteve u



shty deri më 28 Shkurt 2025.

Referuar të dhënave zyrtare të AZHBR, Skema Kombëtare e Investimeve në Bujqësi 2024 ka regjistruar gjithsej 404 aplikime. Nga këto, në fazën filltare rezultuan 360 aplikime të cilat përbushnin kriteret kanë përbushur kriteret e përzgjedhjes.

Interesi më i lartë ka qenë

për investime në mekanizimin e fermave me 305 aplikime dhe për ndërtimin e stallave blegtorale dhe stabilimentet për rritjen e shpendëve me 49 aplikime. Ndërkohë, numri i aplikimeve për masat që lidhen me serrat diellore dhe akuakulturën ka qenë më i kufizuar. Rajonet me kërkesën më të lartë për këtë skemë janë Fieri, Vlora dhe Korça, duke reflektuar interesin e fermerëve për mbështetje në këto zona me tradita bujqësore dhe blegtorale.

Mbështetja financiare është një iniciativë e rëndësishme për modernizimin e bujqësisë dhe blegtorisë, duke siguruar mundësi për zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të konkurrencës në tregjet lokale dhe ndërkombëtare, veçanërisht në rajonet me potencial të lartë prodhimi.

Po ashtu, qeveria ka vënë në dispozicion edhe 5.5 milionë euro për mbështetjen e sektorit bujqësor gjatë vitit 2025 përmes skemës së Investimeve, duke zgjeruar ndjeshëm gamën e përfituesve të mundshëm.

Përzgjedhja e kultivarëve, specialistët: Zgjidhni ato që u rezistojnë kushteve klimatike

Fermerët e zonës së Malit kanë zgjedhur edhe këtë vit disa prej kultivarëve të patates më cilësorë dhe rezistentë ndaj kushteve klimatike të vështira. Varietetet më të përhapura në këtë zonë janë ato që kombinojnë rendimentin e lartë me qëndrueshmërinë në treg dhe cilësinë për konsum, të cilat përdoren gjerësisht për tregun e brendshëm.

“Fermerët kultivojnë kultivar të hershëm të cilat dalin më herët në treg dhe kërkojnë edhe nga ana e konsumatorit”, u shpreh Arben Dulellari, Drejtor i Bujqësisë dhe Mbrotjes së Konsumatorit, në Bashkinë Maliq.

Megjithatë, ky sezon ka sjellë sfida të reja për fermerët për shkak të temperaturave të larta dhe periudhave të zgjatura pa reshje. Kushtet e thatësisë favori-

zojnë shfaqjen e tenjës së patates.

“Duhet bërë kujdes nga mbrojtja për sëmundjet e dëm-

magazinimi i patateve. Patatja është një kulturë që prodhohet masivisht në rang Qarku ku në



tuesve sidomos nga tenja e patates që është dhe dëmtues problematik”, tha ai.

Me rëndësi është edhe

viti ka një prodhim prej mbi 60 mijë ton dhe zë një sipërfaqe të mbjellash prej mbi 2 mijë HA.

Makineritë bujqësore pa TVSH, hapat për të përfituar agrobiznesi

Agrobiznesi është i përjashtuar nga TVSH-ja për importin e makinerive dhe pajisjeve në funksion të realizimit të kontratave të investimit të tyre, pavarësisht nga vlera e investimit.

Për të përfituar përjashtim nga TVSH-ja në importin e makinerive dhe pajisjeve, subjektet agropërpunuese duhet të aplikojnë përmes portalit qeveritar “e-Albania”.

Portali “e-Albania” ndau në rrjete sociale hapat që ndiqen duke aplikuar në zgjedhjen e

shërbimit: “Makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit”.

Më pas duhet të plotësohet formulari dhe të ngarkohen dokumentet e kërkuara, kopje e planit të investimit dhe preventivi.

Nëse aplikimi i plotëson kushtet, mundësohet hedhja e autorizimit në sistem.

Autorizimi “Makineri dhe pajisje në funksion të realizimit të kontratave të investimit

në sektorin e agrobiznesit, pavarësisht nga vlera e investimit” është një autorizim që i jepet operatorit ekonomik i cili vepron në fushën e agrobiznesit. Me anë të këtij autorizimi operatori përfiton nga përjashtimi i pagesës së TVSH-së në momentin e importimit.

Portali “e-Albania” publikoi linkun ku aplikohet, teksa njoftoi se koha për marrjen e shërbimit është 15 ditë dhe dokumenti mbërrin elektronikisht tek rubrika “Dokumentet e mia” dhe në e-mail.

TË NDRYSHME

Pranvera Kastrati emërohet Drejtoreshë e Sekretariatit të CEFTA-s - Rama: Moment krenarie!

Pranvera Kastrati është emëruar Drejtoreshë e Sekretariatit të CEFTA-s. Në një postim në Facebook, kryeministri Rama e cilëson emërimin e shqiptares në këtë post si një moment krenarie.

"Një moment krenarie për të gjithë, emërimi i shqiptares Pranvera Kastrati, në postin e rëndësishëm të Drejtoreshës së re të Sekretariatit të CEFTA-s (Marrëveshja për Tregti të Lirë në Europën Qendrore)

Tashmë një përfaqësuese e Shqipërisë do të punojë në mënyrë efektive me të gjitha palët për zbatimin e Marrëveshjes së CEFTA-s dhe përmbushjen e angazhimeve të përbashkëta drejt integritimit ekonomik të Ballkanit Perëndimor dhe përsheptimit të integritimit me Tregun e Vetëm të BE-së", shkruan Rama.



Dëmet nga zjarret, Denaj: Mbështetje ushqimore për blegtorinë, rivitalizim i të mbjellave

Qeveria adreson një paketë mbështetëse për fermerët, për dëmet e shkaktuara nga zjarret në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

Në konferencën e përbashkët me ministrat e Mbrojtjes

Anila Denaj vlerësoi ndërhyrjen e menjëhershme të qeverisë për marrjen e masave ndaj dëmeve të shkaktuara nga zjarret.

Denaj tha se, "zjarret kanë shkaktuar dëme kryesisht në zonën e jugut të vendit, në Delvinë,

zonat e prekura nga zjarret".

Ministria bëri të ditur se, furnizimi me bazë ushqimore për blegtorinë, në zonën e prekur nga zjarret është mundur në kohë rekord.

"Që prej ditës së martë janë shpërndarë në Delvinë 20 tonë ushqime dhe kemi një kapacitet prej 100 tonë ushqime rezervë për t'u shpërndarë në zonat e tjera të vendit, ku paraqitet nevoja", tha ajo, teksa u bëri apel institucioneve në terren të bëjnë përllogaritjet për nevojat e tjera që paraqiten.

Ajo shtoi se qeveria do të vijë me një paketë mbështetëse për rivitalizimin e një sipërfaqeje toke prej 29 mijë hektarësh me të mbjella.

"Është një sipërfaqje toke prej 29 mijë hektarë, po mendojmë një paketë mbështetëse për të rivitalizuar këtë pjesë me të mbjella", tha Denaj.

Pirro Vengu, atë të Brendshëm Ervin Hoxha dhe drejtorin e përgjithshëm të Emergjencave Civile, Haki Çako, ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural,

në blegtori, bletari por dhe në kullota. Janë 230 koshere me bletë të dëmtuara, 8 stane, ndërsa jemi duke vlerësuar nevojën për ushqim për blegtorinë në të gjithë

Hapen aplikimet për Skemën Kombëtare të Investimeve, Denaj: 2 miliardë lekë mbështetje për bujqësinë

(Vijon nga faqja 2)

të përfitojnë nga disa masa mbështetjeje, duke i mundur kështu të krijojnë një plan të qëndrueshëm dhe tërësor për zhvillimin e fermave të tyre.

Ky program është i hapur për fermerët individualë, si dhe për shoqëritë me status fizik ose juridik, të cilët mund të aplikojnë për ndihmë financiare nëpërmjet Agropikave ose Agjencive Rajonale të Ekstensionit Bujqësor në zonën e tyre.

Skema Kombëtare e Investimeve 2025 ofron 9 masa

mbështetëse: ndërtimin e serave diellore të reja për prodhimin e perimeve, luleshtrydheve dhe rrushit të tavolinës; mbjellje të reja në pemë frutore, ullinj, agrume dhe vreshta; rrjeta antibreshër për pemët, agrumet dhe vreshtat ekzistuese; sistemet e ujitjes me pika në pemëtore dhe vreshta; ndërtimi i ambienteve për mbarështimin e blegtorisë dhe shpendëtarisë; mekanizimi dhe modernizimi i fermave bujqësore dhe blegtorale; pajisjet për përpunim dhe paketim për perime, fruta, rrush, verë, ullinj dhe vaj ulliri;

investime në agroturizëm; koshat dhe rrjetat e peshkimit për akuakulturë.

Aplikimet janë të hapura nga data 30 korrik deri më 30 shtator, dhe fermerët mund të marrin asistencë nga ekipi i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për çdo pyetje ose nevojë për ndihmë.

Skema e Investimeve 2025 ofron mundësi të shkëlqyera për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit bujqësor në Shqipëri, duke kontribuar në rritjen e eksporteve dhe përmirësimin e standardeve të prodhimit.

Parku Kombëtar "Shebenik", zonë pilot e projektit EU4Nature

Parku Kombëtar "Shebenik", i shtrirë përgjatë kufirit lindor të Shqipërisë me Maqedoninë e Veriut, është një nga zonat më të rëndësishme për ruajtjen e natyrës në vend. Me një sipërfaqe prej mbi 34,500 ha, ai përfshin një mozaik habitatesh malore dhe pyjore me vlera të larta ekologjike, gje-

"Pyjet e Vjetra të Ahut në Evropë".

Në Shebenik janë identifikuar dhjetëra lloje gjitarësh, zogjsh, zvarranikësh dhe amfibësh, përfshirë edhe rëqebullin e Ballkanit, një nga speciet më embleme të parkut, i konfirmuar përmes kamerave kurth.

Megjithatë, sfida të tilla si



ologjike dhe kulturore.

Ky park strehon pyje të virgira ahu me moshë mbi 140 vjeç, të shoqëruara me bredhin dhe specie të tjera halore, si dhe livadhe alpine të pasura me bimë mjekësore dhe aromatike si çaj mali, boronicë dhe sanëz. Brenda tij ndodhen 14 liqene glaciare që krijojnë peizazhe mahnitëse, ndërsa pyjet e ahut në Rajcë janë shpallur Trashëgimi Botëror nga UNESCO si pjesë e grupit

nevoja për rishikimin e planit të menaxhimit dhe forcimi i kapaciteteve administrative kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për ruajtjen efektive të kësaj pasurie të rrallë natyrore.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me PNUD Albania bën të ditur se, në këtë kuadër, EU4Nature do të mbështesë:

Rishikimin e Planit të Menaxhimit për të reflektuar

nevojat aktuale të biodiversitetit dhe kërkesat e rrjetit Natura 2000;

Ngritjen e kapaciteteve të stafit të administratave rajonale dhe institucioneve partnere, përmes trajnimeve dhe shkëmbimit të eksperiencave dhe praktikave më të mira;

Investimet për rehabilitimin e habitateve dhe rikuperimin e specieve të rrezikuara, me fokus të veçantë tek llojet me rëndësi për Natura 2000.

Parku menaxhohet përmes katër nënzonave – Qendrore A, Qendrore B, Përdorim Tradicional dhe Rekreacion – duke integruar ruajtjen me përdorimin e qëndrueshëm nga komunitetet lokale.

Me mbështetjen e Projektit të qeverisë shqiptare dhe BE, Parku Shebenik synon të kthehet në një model reference për menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura në Shqipëri, duke forcuar rrjetin Emerald dhe përafruar me standardet Natura 2000.

EU4Nature financohet nga BE dhe Ambasada e Suedisë në Tiranë dhe zbatohet nga UNDP Albania në bashkëpunim me MTM dhe AKZM.

Përcaktohen organizatat sindakale dhe të punëdhënësve, pjesë e Këshillit Kombëtar të Punës

Këshilli i Ministrave përcaktoi në mbledhje organizatat sindakale dhe të punëdhënësve që janë pjesë e Këshillit Kombëtar të Punës.

Vendimi u mor me propozim të ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Sipas listës së miratuar, organizatat e punëdhënësve dhe organizatat sindikale, anëtare të Këshillit Kombëtar të Punës, janë, si më poshtë:

Për organizatat e punëdhënësve:

1. a) Bashkimi i Bizneseve Shqiptare (BIZNES ALBANIA): 1 anëtar, 1 kandidat;

2. b) Shoqata Shqiptare e Bankave (SHSHB): 1 anëtar, 1 kandidat;

3. c) Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë (SHNSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Shoqata Shqiptare e Turizmit (SHSHT): 1 anëtar, 1 kandidat;

1. d) Byroja Shqiptare e Sigurimeve (BSHS): 1 anëtar, 1 kandidat;

2. dh) Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar (KASH): 1 anëtar, 1 kandidat;

3. e) Bashkimi i Investitorëve dhe Industrialistëve Shqiptarë (BI&ISH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Shoqata "Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë" (SH-BPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

1. f) Shoqata Proexport Albania (SHPA): 1 anëtar, 1 kandidat;

2. g) Shoqata e Bukës, Pasticërisë dhe Brumërave (SH-BPB): 1 anëtar, 1 kandidat.

Për organizatat sindikale:

1. a) Bashkimi i Sindikatave të Punësve të Transportit dhe

Shërbimit Civil të Shqipërisë (FSAPSHCSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ë) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Transportit dhe



ave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

2. b) Sindikata e Pavarur e Arsimit të Shqipërisë (SPA-SH): 1 anëtar, 1 kandidat;

3. c) Sindikata e Pavarur e Minatorëve të Shqipërisë (SPMSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

ç) Sindikata e Pavarur e Punonjësve të Ndërtimit dhe Shërbimeve Publike të Shqipërisë (SPPNSHPSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

1. d) Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

2. dh) Federata e Sindikatave të Punonjësve të Shëndetësisë së Shqipërisë (FSPSHSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

3. e) Federata e Sindikatave të Administratës Publike dhe

Telekomunikacionit të Shqipërisë (FSPTTSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

1. f) Sindikata e Punonjësve të Postë – Telekomit Shqiptar (SPPTSH): 1 anëtar, 1 kandidat;

2. g) Sindikata Autonome e Ushqimit, Agrikulturës, Tregtisë dhe Turizmit të Shqipërisë (SAUATT): 1 anëtar, 1 kandidat.

Vendimi përcakton se emërimi i anëtarëve dhe i kandidatëve të Këshillit Kombëtar të Punës bëhet nga ministri përgjegjës për punën, sipas propozimeve të organizatave. Vendimi i mëparshëm i vitit 2022 shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

Nga e hëna 14 korrik 2025, inspektorë të tatimeve, në bashkëpunim me punonjës të bashkisë dhe me policinë bashkiake, kanë nisur kontrollet në tregje, pika grumbullimi, baxho, dyqane dhe njësi shitjeje të produkteve bujqësore dhe blegtorale.

Po kontrollojnë imtësisht tregjet e shitjes së produkteve



të bulmetit dhe të mjaltit, duke kërkuar për çdo shitje nxjerrjen e faturës përkatëse tatimore. Kjo nismë, e ndërmarrë me urdhër të kryeministrit, është pjesë e fazës së re të luftës kundër informalitetit në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Deri tani, 90 përqind e

Fatos Çoçoli: Çfarë fitojmë nga fatura e qumështit?

Po kontrollojnë imtësisht tregjet e shitjes së produkteve të bulmetit dhe të mjaltit, duke kërkuar për çdo shitje nxjerrjen e faturës përkatëse tatimore. Kjo nismë, e ndërmarrë me urdhër të kryeministrit, është pjesë e fazës së re të luftës kundër informalitetit në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë

qumështit që tregtohet tek ne shitet pa faturë. Qëllimi i

ve falas) shtetërore, për fermerët tanë që lëshojnë faturë, duke u regjistruar dhe duke marrë një NIPT (numër regjistrimi pranë organeve tatimore).

Marrja e NIPT-it për fermerët bëhet shumë thjesht. Mjafton që ata të aplikojnë pranë drejtorisë rajonale të tatimeve të fshatit dhe rrethit të tij. Çdo fermer apo tregtar i produkteve ushqimore, që shet qumësht ose mjaltë, duhet të lëshojë faturë tatimore elektronike për çdo shitje, pavarësisht sasisë.

Mungesa e faturimit po ndëshkohet me gjoba dhe paralajmërime për pezullim aktiviteti për rastet e përsëritura. Shoqata të fermerëve kanë kërkuar më shumë informim dhe mbështetje teknike për procesin e fiskalizimit, duke kërkuar kohë adaptimi për fermerët e vegjël. Qeveria është shprehur se nuk ka kthim pas në

zbatimin e ligjit dhe se do të ofrojë asistencë për ata që janë të gatshëm të formalizohen. Ministria e Financave ka folur për trajnime për fermerët dhe tregtarët e produkteve ushqimore, mbi përdorimin e sistemit të fiskalizimit dhe mënyrat e deklarimit të shitjeve të tyre. Këto trajnime duhet të fillojnë sa më shpejt, pasi nevoja për dije nga fermerët është e madhe.

Në këto dhjetë vitet e fundit, kemi humbur 700 mijë krerë bagëti të trasha (lopë) dhe të holla (dhen, dhi). Ose 35 përqind më pak tufa se në vitin 2015. Kjo duhet të na shqetësojë shumë. Nëse subvencioni për blegtorinë bëhet për njësi prodhimi, sikurse e permendi kryeministri, do të shohim rritje të fortë të prodhimit të qumështit, të numrit të krerëve bagëti dhe të formalitetit në bujqësi.

Së dyti, fermerët që punojnë të formalizuar dhe lëshojnë faturë tatimore, do të mund të përfitojnë edhe nga programet e mbështetjes financiare të Bashkimit Evropian.

Së treti, me shitjen e produkteve ushqimore me

Rënia drastikë e numrit të bagëtive tek ne

- Numri i lopëve, dhenve dhe dhive në 2015	2.4 milionë krerë
- Numri i lopëve, dhenve dhe dhive në 2024	1.7 milionë krerë (-35%)

Fatura tatimore për shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale nuk është vetëm një detyrim ligjor, por edhe një instrument i rëndësishëm që sjell dobi konkrete për fermerët, bletarët, konsumatorët dhe shtetin. Po cilat janë këto përfitime?

Së pari, bujqit, fermerët dhe bletërritësit do të mund të përfitojnë nga subvencionet (paratë falas) shtetërore dhe skemat mbështetëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Deri tani, pa NIPT-in tatimor, nuk e kishin këtë mundësi.

faturë tatimore online, si konsumatorë përfitojmë nga një siguri më e madhe në treg. Ai fermer që ka menduar të shesë qumësht të skuaduar apo me ujë, apo mjaltë që të tillë e ka vetëm emrin, me faturën që lëshon kapet shumë kollaj dhe ti si qytetar, po u ankove nga malli i blerë me këtë lloj mashtrimi, e gjen shumë kollaj mashtruesin. Fatura i bën të gjithë shitësit tanë ushqimorë më të disiplinuar dhe të përgjegjshëm për mallin që shesin dhe që ka të bëjë me jetën tonë.

Miratohet Strategjia Kombëtare e Turizmit 2030, Kumbaro: Objektiva të qartë për rritjen e të ardhurave nga turizmi

Këshilli i Ministrave miratoi Strategjinë Kombëtare të Turizmit 2030.



Lajmin e bëri të ditur Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Mirela Kumbaro, përmes një videomesazhi ku shprehet se strategjia është finalizim i një pune dyvjeçare.

“Qeveria Shqiptare sot miratoi Strategjinë Kombëtare të

Turizmit 2030, pas një procesi gati 2-vjeçar hulumtimesh, studimesh dhe konsultimesh, ndërta kjo strategji vendos objektiva të qartë dhe të matshëm për rritjen e të ardhurave nga turizmi deri në vitin 2030, shoqëruar me rritje të kapaciteteve akomoduese dhe përmirësim të standardeve, ndarjen e Shqipërisë në gjashtë rajone turistike dhe detyra të reja për agjencitë shtetërore që lidhen me industrinë e turizmit”, njoftoi Kumbaro.

Strategjia e Turizmit 2030 mbështetet në gjashtë shtylla kryesore: investimet, politika fiskale dhe rregullatore në turizëm, menaxhimi i destinacioneve, zhvillimi i produktit turistik, marketingu i destinacioneve dhe ngritja e kapaciteteve mbështetur në tre parimet bazë që janë aspekti

social, mjedisor dhe ekonomik, ndërsa dokumenti ka kaluar edhe fazën e konsultimit publik me grupet e interesit.

Strategjia Kombëtare e Turizmit 2024-2030 projektin gjithashtu krijimin, përmirësimin dhe konsolidimin e produkteve turistike duke e ndarë vendin në 6 rajone turistike: rajoni turistik i bregdetit të Adriatikut, rajoni turistik verior i brendshëm, rajoni turistik i Tiranës, rajoni qendror, rajoni turistik i bregdetit të Jonit si dhe rajoni turistik jugor i brendshëm.

“Sot mirënjohje për të gjithë stafin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për ata dhjetëra specialistë që u përfshinë në hartimin e kësaj strategjie dhe sigurisht për partnerët tanë të GIZ që japin një kontribut të çmuar në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm”, shprehet Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Mirela Kumbaro.

Dëmet nga moti prekin rëndë edhe kumbullën, pritët çmim i lartë shitjeje

Kushtet e vështira atmosferike këtë pranverë kanë shkakuar dëme të mëdha edhe në prodhimin e kumbullës në Qarkun e Korçës, sidomos nga dëbora dhe ngricat në fazën e lulëzimit të pemëve.

Specialistët e bujqësisë raportojnë se këtë vit prodhimi është tepër i ulët dhe i përqendruar kryesisht në zonën e Devollit dhe te kultivarët e vonshëm, ndërkohë që shumica e pemëtorëve kanë pësuar dëmtime të ngjashme me ato të qershisë.

“Kumbulla pothuajse është dëmtuar totalisht, këtë vit, në përgjithësi të disa zonave sikurse ajo e Devollit që mund të ketë pak prodhim. Pritej prodhim goxha i lartë, por ngricat e fundit dhe dëbora që ra në periudhën e lulëzimit e dëmtoi kulturën e kumbullës si edhe të

qershisë”, tha Nevion Telha, specialist në sektorin e pemë-

garantuar, por çmimi pritët të jetë më i lartë se zakonisht.



tarisë në QTTB.

Për shkak të mungesës së frutit dhe dëmeve të regjistruara edhe në vendet fqinje, tregu i shitjes për kumbullën është i

Kumbulla, ndonëse me rendiment të ulët këtë vit, mbetet një kulturë me potencial të qëndrueshëm për fermerët e zonës.

Vaditja e tokave në Libohovë, Bashkia ndërhyr për pastrimin e rrjetit vaditës

Fermerët e zonës së Libohovës janë angazhuar intensivisht gjatë kësaj periudhe me ujitjen e tokave bujqësore.

Temperaturat e larta dhe mungesa e reshjeve e kanë bërë ujitjen një domosdoshmëri për të garantuar vazhdimësinë e prodhimeve bujqësore.

Sipas specialistëve të bujqësisë në këtë Bashki, po ndiqet nga afër situatën në terren dhe po ndërhyhet aty ku paraqiten vështirësi.

“Në bashkinë Libohovë kultivohet një sipërfaqe e konsiderueshme me kulturën e misrit, e cila ka nevojë për ujitje. Deri në këto momente është kryer ujitja e tretë në gjithë sipërfaqen e kultivuar me këtë kulturë.

Bashkia ka marrë masa në bashkëpunim me Bordin e Kullimit, sepse rezervat ujore të liqenit të Dofitisë, që administrohet nga Bordi i Kullimit, janë edhe për vaditjen e katërt. Me këtë vaditje plotë-

sohet cikli i kulturës së misrit dhe shkon drejt pjekjes së tij,” shprehet specialisti i bujqësisë, Filip Zëra.

Falë bashkëpunimit të mirë me fermerët, ndërhyrjet në rrjetin vaditës po realizohen më shpejt dhe po mundësojnë përmirësimin e shpërndarjes së ujit.

Në këtë mënyrë, synohet jo vetëm të ruhet prodhimi sezonal, por edhe të forcohet qëndrueshmëria në bujqësinë lokale.

Rruga e Dukagjinit, Rama: Kompletohet rrjeti rrugor i Alpeve në funksion të zhvillimit të turizmit

Rruga e Dukagjinit apo aksi Prekal-Lotaj-Ndërlysj, është një ndër segmentet me të rëndësishme të veriut të vendit, që lidh Shkodrën me Lekbibajn në Tropojë e në vijim me Bajram Currin, luginën e Valbonës si dhe me Gjakovën në Kosovë.

Rruga është ende në ndërtim e sipër, ku aktualisht është mbyllur loti 1, Prekal-Kir prej 17 km, dhe ka filluar loti i dytë, Kir-Ndërlysj.

Kryeministri Edi Rama ndau pamje nga ky aks i rëndësishëm ndërsa vlerësoi se ky investim ka një impakt të madh jo vetëm për banorët e fshatrave përreth, Kir, Prekal, Shosh, Shalë, Bradhosh, Xhan, që i lidh me Shkodrën, por

mundëson edhe kompletimin e gjithë rrjetit rrugor të Alpeve në funksion të zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë rurale.

Ky është një projekt i rëndësishëm për veriun e Shqipërisë,

që do të lehtësojë qarkullimin e mjeteve, jo vetëm për banorët e zonës, por edhe për turistët e shumtë që vijnë të zbulojnë Dukagjinin, dhe bukuritë e tjera të veriut të Shqipërisë.





SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO

PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



FINANCIM

Projektligji “Për Censin e Bujqësisë”, qeveria hedh hapa për regjistrimin e fermave dhe njësive ekonomike bujqësore në nivel rajonal dhe kombëtar

Qeveria shqiptare ka ndërmarrë një nismë të rëndësishme për të forcuar dhe modernizuar sektorin bujqësor të vendit me propozimin e Projektligjit “Për Censin e Bujqësisë”.

Ky akt i rëndësishëm ligjor synon të krijojë një bazë të dhënash të konsoliduar dhe të besueshme, thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

“Regjistrimi i Bujqësisë, ose Censi i Bujqësisë, është më shumë se thjesht një mbledhje statistikash; është një mjet kyç për të kuptuar thellësisht peizazhin bujqësor të vendit.”, thuhet në relacionin shoqërues.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është sigurimi i të dhënave bazë të qëndrueshme, të cilat do të ndihmojnë në: përcaktimin e tipologjisë dhe madhësisë ekonomike të fermave; krijimin e një regjistri statistikor të njësive ekonomike bujqësore; përgjithësimin e rezultateve në nivel rajonal dhe kombëtar sipas kritereve metodike të rekomanduara nga Eurostat.

Në thelb, ky cens do të ofrojë një pasqyrë të detajuar dhe të besueshme të gjendjes së bujqësisë shqiptare, duke mundësuar planifikim më të mirë dhe zbatimin e politikave efektive për zhvillimin e qëndrueshëm, shkruan rtsh.al.

Harmonizimi me standardet evropiane
Projektligji është një hap strategjik drejt përmbushjes së angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Planit Kombëtar

të Integritimit Evropian 2024–2026. Ai synon të harmonizojë legjislacionin vendas me Rregulloren Evropiane (BE) 2018/1091 “Statistikat e Integruara të Fermës”, duke siguruar që të dhënat bujqësore të Shqipërisë të jenë të krahasueshme dhe të përdorshme në nivel evropian.

Kjo përputhshmëri është jetike për rrugëtimin e vendit drejt anëtarësimit në BE.

Përfitimet e pritshme dhe implikimet financiare

Zbatimi i këtij projektligji pritet të sjellë përparësi të shumta, përfshirë: përputhshmërinë me terminologjinë dhe përkufizimet e legjislacionit të BE-së; ngritjen e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore, një burim i vlefshëm për analizat dhe hartimin e politikave; përmirësimin e cilësisë së të dhënave statistikore, duke siguruar një panoramë të përditësuar për vendimarrjen.

Censi i Bujqësisë do të zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT) në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Bujqë-

të ofrojë mbështetje thelbësore me stafin e saj të specializuar në terren.

Kostoja totale e parashikuar për realizimin e këtij censi madhor vlerësohet në 890.91 milionë lekë. Këto shpenzime do të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe nga burime të tjera donatorësh.

Pjesa më e madhe e buxhetit, rreth 53%, është dedikuar për pagesat e burimeve njerëzore, duke përfshirë anketuesit, kontrollorët, specialistët e IT-së dhe stafin mbështetës, çka tregon për shkallën e gjerë të angazhimit njerëzor që kërkon ky proces.

Përveç burimeve njerëzore, buxheti përfshin shpenzime për shërbime udhëtimi dhe monitorimi, pajisje, qira ambiente dhe një komponent të rëndësishëm prej rreth 21% për shërbime vizibiliteti dhe fushata publicitare, duke siguruar informimin e publikut dhe një pjesëmarrje sa më të lartë.

Me miratimin dhe zbatimin e këtij projektligji, Shqipëria do të bëjë një hap të madh përpara në aftësinë e saj për të mbledhur, analizuar dhe përdorur të dhënat bujqësore, duke



sisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR). INSTAT do të drejtojë procesin, ndërsa MBZHR do

kontribuar ndjeshëm në rritjen ekonomike dhe në përparimin e saj drejt integritimit evropian.

Grup pune për zgjidhjen e çështjes së vaditjes në Myzeqe

Një grup pune i përbërë nga përfaqësues të institucioneve qeveritare, ekspertë dhe investitorë ka nisur punën për

zëvendëskryeministrja Belinda Balluku dhe ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, ka si objektiv krijimin e

një ndikim të madh në zhvillimin e bujqësisë në Myzeqe. Gjatë viteve të fundit, sipërfaqet e mbjella janë trefishuar, gjë që ka rritur ndjeshëm kërkesat për ujë. Po ashtu, operimi i dy prej HEC-eve më të rëndësishëm të kaskadës së Devollit, pjesë e gjerdanit energjistik të Shqipërisë, ka sjellë sfida të reja për menaxhimin e burimeve ujore, duke kërkuar një koordinim më të ngushtë ndërmjet sektorëve të energjisë dhe bujqësisë”, tha Balluku gjatë diskutimeve.

Takimi i zhvilluar synoi hartimin e një kalendari ndërhyrjesh që do të mundësojë menaxhimin më efikas të ujërave, si dhe mbështetje të qëndrueshme për sektorin e bujqësisë.

Pjesëmarrësit nënvizuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet të gjithë aktorëve të interesuar, për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm.

një plani të detajuar për menaxhimin e ujërave dhe zgjidhjen e çështjes së vaditjes në këtë zonë të rëndësishme bujqësore.

“Liqeni i Thanës ka pasur



adresimin e sfidave që lidhen me menaxhimin e liqenit të Thanës, një burim tërësisht jetik për Myzeqenë.

Ky grup i drejtuar nga

Interes për Paketën e Maleve, paraqiten kërkesat e para për investime në Tepelenë

Zhvillimi i turizmit në Tepelenë po sjell efekte konk-

nga ana e investitorëve.

Një ndër nismat që po nx-



rete në terren jo vetëm përmes rritjes së numrit të vizitorëve, por edhe me interesin në rritje

itet së fundmi është “Paketa e Maleve”, një projekt i lan-

kryeministri Edi Rama, që synon shfrytëzimin e potencialeve natyrore të zonave malore për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe agroturizmit.

“Interesi për zhvillimin e bujtinave apo agroturizmit në tërësi reflektohet edhe në kërkesat që janë paraqitur pranë autoritetit vendor për pajisjen me lejet përkatëse apo për shprehjen e interesit në zona të caktuara. Ky është një tregues pozitiv dhe motivues për rikthimin sërish të jeta komunitare dhe jeta e fshatit,” thotë Aleks Toti, përfaqësues i Bashkisë Tepelenë.

Në Bashkinë e Tepelenës janë paraqitur kërkesat e para konkrete për marrjen në përdorim të tokave në zona malore me qëllim investimi në bujtina, agroturizëm dhe guida natyrore.

Autoritetet vendore po i shqyrtojnë këto aplikime, ndërsa theksojnë se prioritet do t’u jepet projekteve që respektojnë mjedisin dhe ofrojnë zhvillim afatgjatë.

Stacioni i startup-eve, tre të rinj ndërtojnë platforma teknologjike për bujqësinë

Ministrja e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, Delina Ibrahimaj, përcolli mesazhet e tre të rinjve, që përmes inovacionit kanë ndërtuar tri platforma teknologjike për bujqësinë dhe agroturizmin.

Në episodin e tretë të stacionit të Startup-eve, Ibrahimaj tha se po diskutohet zgjidhja teknologjike për bujqësinë dhe agroturizmin dhe rolin e startup-eve në zhvillimin rural.

I riu, Lefter Prifti, krijues i GreenLab-it, u shpreh se ideja për këtë startup nisi duke studiuar tregun e Shqipërisë. “Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm të Shqipërisë. Duke parë dhe trendin, për shume arsye të ndryshme një nga këto është emigrimi dhe mungesa e informacionit të saktë, ne menduam se si këto problematika mund të bashkojnë teknologjinë me agrikulturën. Kështu lindi ideja e GreenLab-it”, tha ai.

Endri Dhaskali, krijuesi i Instecintel vjen si shkurtim i fjalëve insekt dhe inteligjencë. Dhaskali tha po ndërtohet një pajisje smart, një kurth inteligjent që bën kapjen e insektit dhe detektimin e tij duke njoftuar fermerin, agronomin apo përdoruesin fundor se çfarë lloj insekti është kapur nga pajisja dhe çfarë masash duhen marrë në mënyrë që të parandalohet dëmtimi potencial që mund të ndodhë nga ai insekt.

I riu tjetër, pjesë e episodit të tretë të podcastit “Stacioni i startup-eve”, Frajdi Zyla thotë

se bashkë me tre bashkëpunëtorë të tij, ka krijuar platformën MTB, Makina Tërheqëse Bujqësore.

“MTB është një robot, traktor i cili do të jetë i telekomanduar nga fermerët dhe do të bëjë të gjithë punët që i duhen tokës qoftë plugim, brezim,

ujitje, mbjellje, pra gjithçka”, pohoi Zyla.

Ministrja Ibrahimaj është shprehur më herët se “Qeveria ka mbështetur ekosistemin e startup-eve me mbi 10 milionë euro në 3 vitet e fundit, me grante direkte dhe trajnime për më shumë se 200 startup-e”.

MINISTRI SHTETI PËR SIPËRMARRJEN DHE KLIMËN E BIZNESIT

STARTUP ALBANIA

...Stacioni i

STARTUPEVE

Tema:

Teknologjia në Shërbim të Bujqësisë

LEFTER PRIFTI
GREENLAB

ENDRI DHASKALI
INSECTINTEL

FRAJDI ZYLA
MTB

SUBVENCIONE

Skema Kombëtare e Investimeve, mundësi financimi në bujqësi, agropërpunim dhe agroturizëm

Skema Kombëtare e Investimeve 2025 ka hapur mundësi të reja për fermerët, agropërpunuesit dhe sipërmarrësit e sektorit të agroturizmit. Kjo iniciativë, e cila është e hapur për aplikime deri më 30 shtator 2025, ofron një paketë

vlerës së produkteve të tyre”, theksoi ministrja Denaj.

Një nga risitë e këtij viti, theksoi Denaj, është mbështetja e veçantë për agropërpunimin, për të cilin janë alokuar 20 milionë euro.

Një tjetër fokus, nënvizoi

efikasitetin e punës në fushën e bujqësisë”, theksoi Denaj.

Skema gjithashtu i jep mundësinë çdo aplikanti të përfitojë nga më shumë se një masë mbështetjeje, pa kufizime monetare, duke lejuar kombinimin e investimeve në mbjellje të reja, me investime në teknologji dhe mbrojtjen e prodhimeve.

Ministri i Financave, Petrit Malaj, theksoi se qeveria shqiptare po punon për krijimin e modeleve që do të mbështesin fermerët në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke ofruar subvencione dhe kredi të buta.

“Vetëm për vitin 2025 kemi vënë në dispozicion të sektorit të bujqësisë Skemën Kombëtare të Investimeve për vlerën e 20 milionë eurove. Kemi vendosur subvencionet për sektorin e bujqësisë në vlerën 45 milionë euro. Gjithashtu në fillim të këtij viti kemi lançuar edhe kreditë e buta për këtë sektor, në vlerën 250 milionë euro, e cila nëse do të kombinohej edhe me Garancinë Sovrane, të gjithë fermerët do të mund të përfitojnë kredi të buta me një normë interesi 2 % që do të garantohen deri në masën 70% nga shteti dhe vetëm 30% nga fermerët”, deklaroi Malaj.

Drejtoresha e AZHBR-së, Ardita Kuçi, theksoi se procesi i aplikimit është thjeshtuar dhe fermerët mund të aplikojnë me ndihmën e agropikave të vendosura në 20 qytete të vendit, ndërsa aplikimet përfundimtare bëhen pranë zyrave të AZHBR-së.

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural bën thirrje për gjithë fermerët dhe agropërpunuesit që të aplikojnë dhe të shfrytëzojnë mundësitë që ofrohen nga Skema Kombëtare e Investimeve 2025 për të realizuar in-

Denaj, është agroturizmi, që ndihmon në ruajtjen e traditave dhe promovimin e produkteve autentike shqiptare.

“Për të mos lënë jashtë vëmendjes agroturizmin, një nga elementët më të rëndësishëm sot për të ruajtur farën autoktonë, trashëgiminë tonë në kulinari dhe për të ardhur në ndihmë “Paketës së Maleve”, një nisëm e qeverisë shqiptare që sapo ka nisur dhe që në nisje të saj ka 2500 aplikime”, deklaroi Denaj.

mbështetjeje financiare të integruar, që përfshin grante deri në 50% të vlerës së investimeve, si dhe kredi të buta me norma të ulëta interesi.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj, bashkë me ministrin e Financave, Petrit Malaj, dhe drejtoreshën e AZHBR-së, Ardita Kuçi, u bënë thirrje fermerëve në të gjithë vendin që të përfitojnë nga mundësitë që ofrohen për të modernizuar dhe rritur kapacitetet e bujqësisë shqiptare.

Gjatë një vizite të zhvilluar në Agropikën në Lushnjë, zonë kyçe për bujqësinë, ata nënvizuan rëndësinë e këtij programi për rritjen e konkurrueshmërisë së produkteve shqiptare në tregjet ndërkombëtare dhe për zhvillimin e mëtejshëm të sektorëve të bujqësisë dhe agroturizmit.

Ministrja e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Anila Denaj bëri të ditur se Skema e Investimeve 2025 përfshin 9 masa mbështetjeje, të cilat ofrojnë mundësi financimi për investime në bujqësi, agropërpunim dhe agroturizëm.

“Fermerët mund të aplikojnë për grante deri në 50% të shpenzimeve për ndërtimin e serave, mekanikën bujqësore, sistemet e mbrojtjes së prodhimeve dhe zhvillimin e agropërpunimit, duke krijuar mundësi të reja për rritjen e

Përveç granteve, kjo skemë ofron edhe mundësinë për të përfituar kredi të buta me një normë interesi prej vetëm 2%, ku shteti mbulon deri në 70% të kolateralit.

“Kjo do të ndihmojë fermerët të financojnë investime të nevojshme për modernizimin e prodhimit dhe për të rritur

vestime të qëndrueshme dhe për të kontribuar në zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Shqipëri.

Mbështetja me grante në masën 50 % do të shoqërohet për gjatë gjithë vitit me asistencë të drejtpërdrejtë për disbursimin e masës së parë prej 30 %, brenda dhjetorit.

Hyn në fuqi vendimi i qeverisë për tarifat e reja për përdorimin e kullotave dhe livadheve

Qeveria miratoi së fundmi një vendim të rëndësishëm që

zuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe synon të bëjë



rregullon përdorimin e fondit kullësor në Shqipëri. Vendimi i Këshillit të Ministrave, i cili ka hyrë tani në fuqi, ka përcaktuar tarifa të reja për përdorimin e kullotave dhe livadheve për disa kategori kryesore.

Ky vendim, i cili shfuqizon atë të vitit 2009, është propo-

më efektiv dhe transparent menaxhimin e burimeve natyrore të vendit.

Tarifat e reja janë ndarë në tri grupe kryesore:

Për kullotje dhe kositje, tarifat për blegtorët që për-

dorin kullotat për bagëti ose për kositjen e barit do të jenë sipas një shtojce të re, e cila i bashkëlidhet vendimit.

Për veprimtari të tjera, janë përcaktuar tarifa specifike për përdorimin e kullotave dhe livadheve për qëllime shoqërore, shëndetësore, sportive dhe turistike.

Për energji të rinovueshme, ky vendim shton një kategori të re tarifash, duke lejuar përdorimin e këtyre sipërfaqeve edhe për prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Për zbatimin e këtij vendimi do të jenë përgjegjëse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kjo rregullore e re pritet të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në mbrojtjen e fondit kullësor dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale.

SHTOJCA NR. 1			
Tarifat për dbënie në përdorim të kullotave e livadheve për kullotjen e bagëtive ose për kositjen e barit			
Kullotje		Tipi i kullotës	
		Dimërore lekë/krerë/vit	Verore lekë/krerë/vit
1	Dhen	200	200
2	Dhi	250	250
3	Gjedh	1000	1000
4	Njëthundrakë	1200	1200
Kositje bari		Dimërore lekë/m ²	Verore lekë/m ²
		2	
Ndërtime		Dimërore lekë/m ² /vit	Verore lekë m ² /vit
1	Qendër stani e rrethuar	100	100
2	Qendër përpunim bulmeti	150	150
3	Ngrehinë banimi për barinjtë	50	50
4	Objekte ndihmëse për barinjtë	150	150

SHTOJCA NR. 2			
Tarifat për dbënie në përdorim të kullotave dhe livadheve për veprimtari shoqërore, shëndetësore, sportive e tur.			
Aktiviteti	Tarifa lekë/ha/vit		
	Për 1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
Ndërtime agroturistike	100 000	80 000	65 000
Veprimtari sportive	140 000	100 000	85 000
Veprimtari çlodhëse dhe kampingje	100 000	85 000	65 000

SHTOJCA NR. 3			
Tarifat për dbënie në përdorim të kullotave dhe livadheve për prodhimin e energjisë së rinovueshme			
Aktiviteti	Sipërfaqja (ha)	Kohëzgjatja (vjet)	Tarifat (lekë/vit)
Park fotovoltai	Deri në 10	Deri në 10	192 000
		Mbi 10	173 000
	Mbi 10	Deri në 10	156 000
		Mbi 10	132 000
Vendosje aerogjeneratorë	Deri në 10	Deri në 10	120 000
		Mbi 10	100 000
	Mbi 10	Deri në 10	90 000
		Mbi 10	70 000



INFORMACIONE

Paketa e Maleve - Deri tani mbi 3 mijë shprehje interesi, zv. ministri i Ekonomisë: 500 projektet e para të përfunduara pa taksa

Më shumë se 3 mijë qytetarë kanë shprehur interesin e tyre për të përfutuar nga Paketa e Maleve. Zëvendësministri i Ekonomisë sqaron për Report Tv se aplikimet janë të përqëndruara kryesisht në veri të vendit, ndërsa lehtësitë fiskale do t'i përfitojnë ata që ndërtojnë të parët biznesin në tokën që do të marrin në pronësi

Nga zonat më malore të veriut të Shqipërisë e deri në skajin më jugor të saj, interesi i qytetarëve për të përfutuar nga 'Paketa e Maleve' është i lartë.

"Janë 3175 shprehje interesi që kanë ardhur në këtë platformë. Janë të shpërndara në të gjithë territorin e Shq-

bashki do të shpallë zonat me përparësi zhvillimi në territorin e vet. Bashkitë po punojnë për shpalljen e këtyre zonave. Kur të shpallen zonat, qytetarët që kanë shprehur interes do të duhet të dorëzojnë kërkesat e tyre pranë bashkive", pohon zëvendësministri.



ipërisë por zonat me kërkesë më të madhe janë ato zona ku edhe ka pasur mungesë të titujve të pronësisë. Përgjithësisht në veri dhe në juglindje të vendit", shprehet Enkelejd Musabelliu, zëvendësministër i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Prej 3 javësh qytetarët po shprehin interes për të marrë në pronësi tokën në mënyrë që më pas të zhvillojnë në projekt biznesi.

"Hapi i radhës është përcaktimi i zonave me përparësi zhvillimi gjë që do të bëhet nga ana e bashkive, pra secila

Pasi të jenë miratuar 'zonat për zhvillim', do të nisë aplikimi real i qytetarëve, ku duhet të dorëzojnë edhe një sërë dokumentesh për të përfutuar pronën.

Aplikimi real i qytetarëve me dokumentacionin përkatës që do të nisë pas shpalljes së zonave me përparësi zhvillimi nuk do të ketë afat, të gjithë qytetarët që mund të përfitojnë nga ky ligj do të mund të aplikojnë dhe përfitojnë përsa kohë ligji të jetë në fuqi dhe s'do ketë afat kufizues.

"Do të dorëzojnë një GENPLAN të sipërfaqes që ata duan

të zhvillojnë së bashku me planin e biznesit se si duan ta zhvillojnë dhe dokumentacionin që mbështetet faktin që janë posedues të asaj prone. Pastaj bashkia bën verifikimin nëse prona plotëson kriteret për tu dhënë në përfutim, më pas miratohet lista e poseduesve faktik", thotë Musabelliu.

Lehtësitë fiskale, të parashikuara në Paketën e Maleve, do t'i përfitojnë vetëm ata që përfundojnë të parët projektin për të cilin kanë aplikuar në bashki.

"500 subjektet e para që arrijnë të përfundojnë projektin për të cilin kanë marrë pronësinë e pronës shtetërore dhe marrin lehtësi fiskale", tha Musabelliu.

Megjithatë nuk do të jenë përfutues vetëm 500 projekte. Edhe përtej kësaj shifre mund të ketë ndërtime në zonat malore të marra në pronësi nga qytetarët por pa lehtësi fiskale.

"Qëllimi është dhënia e tokës në pronësi për ta zhvilluar për ekonominë malore dhe do ta kenë të gjithë ata që do të plotësojnë kriteret për të marrë pronën. Por lehtësitë i përfitojnë vetëm 500 të parët", tha Musabelliu.

Për 500 të parët për 10 vite nuk do të ketë taksë të ndikimit në infrastrukturë, taksë të pasurisë së paluajtshme, TVSH dhe tatimi mbi fitimin.

Fokusi i "Paketës së Maleve" do të jetë në veri, një hap që vlerësohet për të frenuar shpopullimin dhe për të nxitur punësimin.

Temperaturat e larta ndikojnë në pemëtore. Ujitja dhe trajtimet kimike, thelbësore për cilësinë e prodhimit

Gjatë kësaj periudhe të gjatë me temperatura të larta dhe mungesë reshjesh, niveli i lagështisë në tokë ka qenë shumë i ulët, duke krijuar vështirësi për kulturat bujqësore.

Për pasojë, fermerët që merren me kultivimin e pemëve frutore janë detyruar të shtojnë ndjeshëm ujitjet, si një masë e domosdoshme për të shmangur stresin e bimëve dhe dëmtimin e frutave.

"Kjo është ndier sidomos në pemëtoreset intensive, me sistem mbështetës dhe rrënjor të cekët, të tipit 'spur', që kanë kërkesë më të lartë për ujitje dhe me intervale më të shpeshta. Jo të gjitha zonat kanë mundësi ujitjeje, por kanë pasur zgjidhje alternative, me puse apo me sonda, dhe kush ka qenë afër lumenjve ka marrë drejtpërdrejt nga aty me traktor-pompë," thotë specialist Nevison Telha nga sektori i pemëtarisë në Qendrën e Transferimit të Teknologjive Bujqësore.

Përveç ujitjes, një tjetër aspekt i rëndësishëm gjatë kësaj faze ka qenë vazhdimi i trajtimeve kimike, të cilat ndihmojnë në mbrojtjen e bimëve nga sëmundjet dhe dëmtuesit.

"Aktualisht kemi bërë trajtime për brezin e dytë të krimonit të mollës. Jemi në kushte optimale për të goditur maksimumin e larvave. Shërbimet e tjera janë

kryesisht spërkatja e ushqyesve, që bëhen këtë periudhë, kryesisht me potas apo kalium, e shoqëruar me aminoacide," thotë z. Telha.

Specialistët këshillojnë që fermerët t'i zbatojnë këto masa jo vetëm për të ruajtur dhe përmirësuar cilësinë e prodhimit aktual, por edhe për të ndikuar pozitivisht në diferencimin e sythave frutorë për sezonin e ardhshëm.



Formalizimi i tregut ushqimor, Malaj: 103 tonë mallra të bllokuara në 20 ditë

Aksioni për formalizimin e tregut të produkteve bujqësore dhe blegtorale, si dhe për rritjen e sigurisë ushqimore, ka dhënë rezultatet e para brenda një kohe të shkurtër.

Në 20 ditë janë inspektuar 283 subjekte dhe janë bllokuar 103 tonë mallra që nuk përbushnin standardet ligjore dhe të sigurisë ushqimore.

Ministri i Financave, Petrit Malaj tha se "tashmë ka përfunduar faza e parë në terren, në kuadër të përpjekjes së vazhdueshme të forcimit të ligjshmërisë fiskale në sektorin e produkteve bujqësore dhe blegtorale".

"Administrata Tatimore do të nisë fazën e dytë të monitorimit, që synon verifikimin në vazhdimësi shoqërimin e produkteve me faturë tatimore", tha Malaj.

Sipas ministrit Malaj, qëllimi i këtij operacioni është formalizimi i tregut, rritje e sigurisë ushqimore dhe mbrojtje e konsumatorit.

"Zero tolerancë ndaj subjekteve, pjesë e zinxhirit të tregut të produkteve bujqësore dhe blegtorale, që nuk respektojnë ligjin", u shpreh Malaj.

Objektivat e aksionit përfshijnë formalizimin e tregut të produkteve bujqësore dhe

blegtorale, rritjen e sigurisë ushqimore për konsumatorin, gjurmueshmërinë e produkteve nga ferma në tryezë, si dhe mbrojtjen e fermerëve dhe

prodhuesve të ndershëm.

Autoritetet paralajmërojnë se kontrollet do të intensifikohen në ditët në vijim në të gjithë territorin e vendit.

20 DITË

nga përpjekja për formalizimin e tregut të produkteve bujqësore/blegtorale dhe rritjen e sigurisë ushqimore

REZULTATET

103 TON

sasia totale e mallrave të bllokuar

283 SUBJEKTE

të inspektuara Total

www.tatime.gov.al

Anëtarësimi në BE, ekspertët këshillojnë biznesin të nisë përshtatjen me tregun evropian

Në një kohë rekord, ndërmarrjeve shqiptare iu duhet të informohen e reagojnë për të dalë në tregun evropianë prej më se 465 milionë konsuma-

i rrethanave që së shpejti do të jetë realiteti i vendit.

"Në shumë tryeza që ne organizojmë del si një shqetësim shumë i madh nga përfaqë-

por të shoqërohen gjithashtu me komunikim", tha Krisela Haçkaj eksperte e integritit evropian.

Përveç komunikimit, ekspertët shohin si faktor veprues përgatitjen e atyre që shumë shpejt do iu duhet të prodhojnë brenda një tregu evropianë.

"Është sfidues jo vetëm për qeverinë që është pala kryesore me të cilën KE negocion, por dhe për shoqërinë. Anëtarësimi i përsheptuar duhet të përkthehet në një ingranazh me efikas të përfshirjes së grupeve të interesit. Nëse shpejtësia nuk do të jetë pak e shumë e përafërt do të kemi humbës nga ky proces", tha Haçkaj.

Ekspozimi i përfutimeve dhe rrezikut për biznesin janë pjesë e ingranazhit të transformimit drejt BE-së që nuk mund të shihet vetëm si detyrim i aktorit kryesor për informim se sa si përfshirje aktive e vetë biznesit



torë. Ekspertët e fushës bëjnë thirrje që në këtë volum pune intensive, grupet e interesit, biznes e konsumatorë të përfshihen duke nisur nga sqarimi

suesit e biznesit, mospërgatitja ende e grupit të interesit për të qenë pjesë e tregut të përbashkët unik. Do të thotë po reformat janë shumë të rëndësishme

Siguria ushqimore, përfundon faza e parë e fushatës ndërgjegjëse me bizneset bujqësore

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), po bashkërendon punën me institucionet e linjës për rritjen e sigurisë ushqimore në tregje.

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional me Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) dhe Agjencinë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), ka përfunduar me

sukses fazën e parë të fushatës së ndërgjegjësimi në të gjithë vendin, e fokusuar te operatorët e biznesit në sektorin bujqësor.

Kjo fushatë, e zhvilluar në mënyrë të koordinuar, kishte si synim kryesor ndërgjegjësimin dhe dialogun me subjektet që operojnë në fushën e importit, tregimit dhe përdorimit të inputeve bujqësore, pikat e grumbullimit, si dhe me operatorët profesionistë dhe fermerët

që merren me prodhimin e fruta-perimeve dhe bimëve medicinale.

Fushata funksionoi si një platformë komunikimi të drejtpërdrejtë me bizneset, me qëllim: Identifikimin e sfidave në terren, Marrjen e sugjerimeve për përmirësim, Ofrimin e këshillimit teknik dhe ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimi në përdorimin korrekt dhe të sigurt të inputeve bujqësore.

KËNDI I EKSPERTIT

(Vijon nga gazeta 513)

Pema më e shijshme. Mështekne e ëmbël (Betula lenta)

Pema më e shijshme. Mështekne e ëmbël (Betula lenta) një specie druri Gama vendase: Amerika e Veriut. Një pjesë e pyjeve kodrinore Appalachian, mështekna e ëmbël ofron disa opsione të ngrënshme për alpinistët e uritur. Lëvorja e saj mund

**Drurë të Mështeknës së ëmbël (Betula lenta)**

të hahet e papërpunuar, degëzat e saj mund të përdoren për të bërë çaj dhe birra e thuprës mund të prodhohet nga lëngjet e saj.

Mështekna e ëmbël (Betula lenta), e njohur gjithashtu si Mështekne e zezë, është një specie mështekne e lindur në Lindje të Amerikës së Veriut.

Përshkrimi. Betula lenta është një pemë gjetherënëse me madhësi mesatare që arrin 30 metra e lartë, veçanërisht deri në 35 m me një trung deri në 60 cm diametër. Lartësitë nga 15 m deri në 24 m janë më tipike. Në pemët më të reja lëvorja është karakteristike për shumicën e mështeknave me lëvore të lëmuar dhe thjerrëza të dallueshme horizontale. Ndonjëherë gabimisht identifikohet si një pemë qershie.

Degët, kur kruhen, kanë një aromë të fortë të gjelbërimit të dimrit për shkak të metil salicilatit, i cili prodhohet në lëvore.

Gjethet janë alternative, vezake, 6–15 cm të gjata dhe 4 deri në 8 cm të gjera, me një skaj të dhëmbëzuar imët. Lulet janë vila të pjalmuara nga era 2,5–3 cm të gjata, vilat mashkullore të varura, vilat femra të ngritura. Fruti, që piqet në vjeshtë, përbëhet nga fara të shumta të vogla me krahë të paketuara midis brakteve vile. Prodhimi i farës ndodh kryesisht në pemët që janë midis 40 dhe 200 vjeç, megjithëse të lashtat e lehta mund të ndodhin që në 15 vjet dhe për sa kohë që pema jeton.

Mosha. Betula lenta më i vjetër i njohur është konfirmuar të jetë 368 vjeç dhe speciet mund të jetojnë edhe më gjatë në një pyll të lashtë të pashqetësuar. Një vlerësim i përafërt i moshës mund të përcaktohet nga sa shtresa lëvore ka një pemë. Në përgjithësi, lëvorja e re e lëmuar e pemës fillon të ndahet rreth moshës 40-50 vjeç dhe më pas fillon të zhvishet nga trungu rreth moshës 70-80 vjeç. Më pas ajo zëvendësohet nga një shtresë tjetër lëvore, e cila do të fillojë të zhvishet rreth 130-150 vjet. Shtresa e tretë do të zhvishet kur pema të ketë arritur moshën 200–210 vjeç dhe të arrijë statusin e “rritjes së vjetër”. Kjo do të vazhdojë të ndodhë për sa kohë që pema të jetojë, por shtresat individuale të lëvres bëhen të padallueshme pas afro 250 vjetësh. **Shpërndarja dhe habitat.** Lloji është vendas në

Lindje të Amerikës së Veriut, nga Maine jugore në perëndim deri në Ontario më jugore dhe në Jug në malet Appalachian deri në Gjeorgjinë veriore. (Harta).

Përdorimet. Druri i mështeknës së zezë është i rëndë në 47 paund për këmbë kub dhe për-

doret për mobilje, punime mulliri dhe kabinete. Ai është i ngjashëm me drurin e mështeknës së verdhë dhe shpesh nuk dallohet prej tij në tregtinë e lëndës drusore.

Lëngu rrjedh rreth një muaj më vonë se sa lëngu i panjave, dhe shumë më shpejt. Pemët mund të preken në mënyrë të ngjashme, por duhet të mblidhen rreth tre herë më shpesh. Lëngu i mështeknës mund të zihet njësoj si lëngu i panjave, por shurupi i tij është më i trashë (si melasa). Ajo mund të përdoret për të bërë birrë mështekne. Lëvorja e brendshme mund të hahet e freskët si ushqim urgjent. Lëvorja e brendshme e tharë mund të përdoret si trashës në supa etj., ose mund t'i shtohet miellit gjatë përgatitjes së bukës etj. Degët dhe lëvorja e brendshme mund të zhyten për të bërë çaj.

Mështekna e zezë dikur ishte mbledhur gjerësisht për të prodhuar vaj të gjelbërimit të dimrit, pema ishte e rrezikuar në kufi deri në vitet 1950-1960 kur u shfaq vaji sintetik i dimrit.

Në mjekësi. Lëvorja është anthelmintike, astringente, diaforike, diuretike dhe stimuluese. Një çaj i bërë nga lëvorja përdoret në trajtimin e etheve, dhimbjeve të stomakut dhe sëmundjeve të mushkërive, thuhet se është një tonik i shkëlqyer në rastet e dizenterisë. Një vaj esencial i distiluar nga lëvorja është anti-inflamator, analgjezik dhe rubefacent. Përdoret në trajtimin e reumatizms, infeksioneve të fshikëzës, nevralgjisë etj.

Pema e mjekësisë. Ginkgo (Ginkgo biloba)

Pema e mjekësisë, Ginkgo (Ginkgo biloba), është një specie bimore me Gama vendase: Kina. Statusi i ruajtjes: I rrezikuar

Ginkjoja këmbëngulëse ka ekzistuar që nga dinozaurët – duke



bërë debutimin e saj në të dhënat fosile rreth 200 milionë vjet më parë. Pema prodhon gjethë të bukura në formë erashke, të cilat janë bërë një element kryesor i mjekësisë tradicionale kineze.

Ginkgo biloba, i njohur zakonisht si xhinko ose gingko i njohur gjithashtu si pema e flokëve të vajzës, është një specie e pemës së gjimnospermës vendase në Azinë Lindore. Është specia e fundit e gjallë në rendin Ginkgoales, e cila u shfaq për herë të parë mbi 290 milionë vjet më parë, dhe fosilet shumë të ngjashme me speciet e gjalla, që i përkasin gjinisë Ginkgo, shtrihen në epokën e Jurasikut të Mesëm afërsisht 170 milionë vjet më parë. Pema u kultivua herët në historinë njerëzore dhe mbetet e mbjellë zakonisht dhe konsiderohet gjerësisht si një fosil i gjallë.

